

Koha Jonë

Greva e urise, Topalli "hap" dyert e Kuvendit

E Shtune, 15 Nentor 2008

Kryetarja e Kuvendit, Topalli "hapi" diten e djeshme edhe dyert e Parlamentit per te gjithe personalitetet qe duan te depertojne ne ambientet, ku po mbahet greva e urise se 10 deputeteve. Kjo hyrje do te jete e lire, por me kushtin thelbesor se keta personalitete duhet te pajisen paraprakisht me nje leje te Kuvendit per te realizuar kete vizite. Ky "leshim" eshte bere ne kushtet kur perfaquesues te larte te politikes ne vend dhe nderkombetare po shfaqin interesin te takohen me grevistet. Por dhe pas refuzimit qe iu be ish-presidentit Moisiu, dhe dy deputeteve belge.

Ndryshimi

Ne viziten qe kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli zhvilloi paraditen e djeshme ne sallen ku 10 deputetet po mbajne edhe greven e urise, ajo u komunikoi perfaquesuesve te partive politike se ata mund te vizitheshin nga personalitetet te ndryshme, te cilet ishin te interesuar per gjendjen e tyre shendetesore dhe per motivet qe i shtyne drejt greves se urise. Por sipas kryetares se Kuvendit, keto vizita do te realizohen vetem ne rastin kur keta persona paraprakisht te kishin marre lejen e posacme nga Kuvendi, ne lidhje me kete vizite. Per sa i perket deputeteve te tjere te Kuvendit, ata ishin te lire qe ne cdo moment te dites dhe te nates te vizitonin koleget e tyre te "ngujuar", tashme prej pese ditesh, ne ambientet e salles se seancave, ne Kuvend. Burimet bejne te ditur se kryetarja Topalli asnjehere nuk eshte shprehur kunder vizitave ne salle, por keto normalisht duhet te kryheshin ne menyre te kontrolluar, ashtu sic ndodh ne rast te protestave te tilla.

Eurodeputetet

Dy deputete belge qe erdhen dje ne menyre te posacme per te vizituar deputetet shqiptare qe ndodhen ne greve urie arriten te takojne deputetet vetem pasdite. Delegacioni i kryesuar nga deputeti liberal belg Denis Ducarme, si dhe nga Claude Moniquet, Presidenti i Qendres Strategjike Evropiane per Inteligjencen dhe Sigurine, jane lejuar te futen vetem pasdite vone ne sallen e Kuvendit, ku deputetet po bejne greven e urise, pasi ne mesdite, ata jane ndaluar para ambienteve te Kuvendit nga punonjesit e gardes. Gjate takimit me deputetet ne greven e urise, deputeti belg Ducarme eshte shprehur se ngjarja e greves se urise se deputeteve shqiptare eshte degjuar mjaft, ndaj dhe kjo eshte arsyaja e vizites. Deputeti belg eshte shprehur se e mbeshtesin kete greve, sepse kjo nuk eshte thjesht nje grindje partish, por eshte nje perpjekje per te shpetuar natyren e regjimit. Ai garantoi se Evropa ka ngritur pikepyetje per ate se cfare po ndodh ne Shqiperi. "Edhe une me t'u kthyer, do te sqaroj koleget dhe gjithashtu do ti kerkoj qeverise belge qe te mbaje nje qendrim per kete ceshtje", theksoi deputeti belg, Ducarme. Fatjona Mejdnini

Malaj-PS

"Dialogu politik organizohet mes partive politike dhe jo mes individeve. Rer sa i perket krizes mendoj se nga pikepamja etike eshte nje moment qe kerkon nje vleresim sa me te drejte. Vemendja dhe tensioni mbi keto ligje do te cenohet", u shpreh Malaj.

© 1991 - 2008 Koha Jone - Te gjitha te drejtat e rezervuara Programing ©
[WebPhotoPro](#)